

FJALA E DEPUTETIT FLAMUR NOKA

E ENJTE 21 SHTATOR 2023

Faleminderit!

Në fakt, do ta nisja diskutimin me rendin e ditës, me temën e pensioneve, por kur mister “Dosja 184”, në vend që të flasë për burgun, merr përsipër të flasë për Kukësin, sigurisht që e kërkon një përgjigje. Ulsi, ti duhet të ishe i pandehur, por në Shqipëri nuk ka drejtësi. (Ndërhyrje pa mikrofon nga salla) Po, Toni, nëse ti do ta kishe lexuar “Dosjen 184”, nuk do të buzëqeshje, por do të ngërdhesheshe. Ti buzëqesh, sepse nuk e ke lexuar. Lexoji të gjitha! Ky këtu, siç e tha edhe doktor Berisha, është kriminel elektoral. Të gjithë mund të flasim për zgjedhje, vetëm ky nuk duhet të hapë gojën, sepse është i damkosur, i kapur në qark, me zë dhe me figurë, si një kriminel elektoral. Mirë që flet, por flet për Kukësin, për të cilin kam përshtypjen që prej vitesh i dëgjon vetëm emrin! A e di ti se qarku i Kukësit sot është qarku më i shpopulluar dhe më i varfër në Shqipëri? A mund t’u thuash kuksianëve pse duhet të të votojnë ty, Ulsi? Se je një hajdut, një kriminel elektoral, një dogman! Si qeveri po flas, jo vetëm ti si individ. Për çfarë duhet të të votojnë ty kuksianët? A e di ti se Kukësi këtë varfëri ekstreme e ka dhuratë nga ty dhe nga qeveria jote, edhe këtë shpopullim, këtë eksod biblik e ka dhuratë po nga ty dhe nga qeveria jote? A e di ti, Ulsi, se dikur qarku i Kukësit kontribuonte me 18% të prodhimit të brendshëm bruto në nivel kombëtar? A e di ti se me statistikat tuaja, matjen e fundit të vitit 2020, ky kontribut ka rënë në 2%? A e kupton ku është katandisur?! Pa më thuaj, pse duhet të të votojnë? Edhe për çështjen e rendit të ditës, për pensionistët, do të them dy fjalë. Pa më thuaj, pse duhet të të votojnë pensionistët, kur pensionistët i ke lënë në nivelin më të mjerueshëm të mundshëm që mund të ketë një njeri në të gjithë Europën? Kur minimumi jetik sot është 200 dollarë, një pensionist në fshatrat e Kukësit, apo në të gjithë fshatrat e Shqipërisë, ti e ke lënë me 95 dollarë. Pra, pensionisti ka kushte jetese mizerable. Kjo është vëmendja. Pse? Sepse kujtohesh dhe u jep 50 mijë lekë para zgjedhjeve.

Edhe në Kukës, prandaj flet dhe kakaris, këto do të bësh; e keni skemën ju. Kanë filluar kryetarët e partive, të celulave tuaja, të dalin nëpër fshatra të blejnë me 100 euro, me 200 euro votën, por mbaje mend: do të merrni përçmimin. Nuk do ta merrni përçimin, se po shpërndani para. Jo. Do të merrni përçmimin se e meritoni, sepse i keni përçmuar Kukësin dhe kuksianët prej 10 vjetësh. A e di ti që me statistikat zyrtare të shtetit tënd, Ulsi, në periudhën 2014-2020, rezultoi që ekonomia ka pasur rritje me 13,7%? Po në Kukës, a e di sa është ulur? Ti nuk di gjë. Në vitin 2012, me statistika, varfëria në qarkun e Kukësit ishte 12,3%. Sot, a e di sa është? Merr pagesën e ndihmës ekonomike dhe pensionet dhe llogariti, s’ke nevojë të hysh më në detaje. 60% e atyre njerëzve që banojnë sot atje janë në nivele ekstreme të varfërisë. Për çfarë duhet të të votojnë ty, se je ndonjë farë kingu, apo se ke lënë mjekër?! Për çfarë duhet të të votojnë ty, apo këtë Sulltan Surrelin tënd, se i ke vjedhur, i ke plaçkitur, i ke dhunuar dhe i ke shkatërruar?! Për çfarë? Prandaj, duhet të kesh parasysht një gjë, Ulsi, kur të flasësh duhet t’i mendosh gjërat dhe duhet ta njohësh realitetin, por ju jeni mësuar që këtu nuk flisni asnjëherë në lidhje me realitetin. Ju gjithmonë flisni “si e ëma e Zeqos në majë të thanës”. Ju bëjnë hartime të tjerët dhe i lexoni. Edhe Elisa, lexoi qëparë një hartim pa asnjë lidhje me realitetin, sikur kjo qeveri ishte duke u këputur për pensionistët. Ndërkohë, më thuaj, Ulsi, më trego ti, çfarë mund të bësh me 96 dollarë? Si e përballon jetën e një muaji një pensionist në fshatrat e Kukësit apo edhe të Dibrës tënde? 100 dollarë u duhen për ilaçe pensionistëve, ndërsa ti u jep 96 dollarë. Pa më thuaj, Ulsi, për çfarë duhet të të ndjekin ty mbrapa dhe të të votojnë? Po, ka një gjë, e tha edhe zotëria qëparë këtu, se si thënie ishte e saktë, por, kur vjen që të përshtatet me realitetin, duhet t’i bëjmë inversin. Çfarë tha? “Shtetarët dhe politikanët diferencohen”. Po, ka një diferencë, shtetarët mendojnë për brezat e ardhshëm. Pa më thoni, kjo qeveria juaj ka ndonjë shtetar, që nga “sulltani” e poshtë, që ka menduar...?

Po, keni menduar për një gjë, për ta shpopulluar dhe për ta shkatërruar këtë vend! Po, por për brezat e ardhshëm këtu nuk ka asgjëkundi në horizont një shenjë. Ju keni treguar në këta 10 vjet që mendoni vetëm për zgjedhjet e ardhshme. Vidhni një palë zgjedhje, vidhni katër vjet para nga buxheti dhe nga taksat e shqiptarëve, për të ardhur dita të vidhni prapë zgjedhjet. Kjo është. E nise që me Shukriun ti, Ulsi. Ti ishe autori kryesor i skemës së vjedhjes dhe të blerjes së votave dhe ja ku jemi sot. Ulsi, në Shqipëri, ti dhe “sulltani” yt nuk e njihni votën e lirë. Votën ju e quani mall, prandaj nuk e konsideroni ju, se thoni: ne kemi para dhe e blejmë. Pra, nuk ekziston vota në konceptin tënd dhe të sulltanit, Ulsi, as edhe të Elisës. Jo, nuk ka...! Elisa programohet me buton para se të vijë, i shtypet butoni këtu dhe hartimet pa pushim, ndërsa ti, Ulsi, flet pa lidhje, sepse të urdhëron Elisa dhe, herë pas here, kur lodhet ajo, ta fusin edhe ty kasetën, por me realitetin nuk keni asnjë lidhje. (Ndërhyrje pa mikrofon) Po, se ua rrisni pagat anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, po, po, ua rrisni ju. Ja, ku e keni Gjykatën Kushtetuese. Po a ka turp dhe pashpirtësi më të madhe, more, që një anëtar i Gjykatës Kushtetuese, të cilit doni t’ia rrisni tani rrogën, i jepni rrogë sa 100 pensionistë në fshatrat e Kukësit? Domethënë, 100 pensionistë të fshatrave të Kukësit nuk e marrin në muaj rrogën e një anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Po pse? Sepse gjykatësin do ta blejnë këta, se u duhet për vendimet, ndërsa pensionistit pse t’ia rrisin rrogën këta? Jo, sepse kur vjen puna e fushatës, i thonë: “Ka dalë Zeusi këtu. E ka emrin “sulltan Surreli” dhe do të japë 50 mijë lekë shpërblim” (se ia quajnë edhe shpërblim), madje edhe dhuratë ia quajnë këta për zgjedhjet! Kjo është, Ulsi, ndaj duhet të kesh cipë, duhet të kesh fytyrë që të skuqesh e të zverdhesh dhe të mos kesh kurajën të thuash këto dokrrat, që thoni ju, por ju nuk keni asnjërin nga këto. Ju keni vetëm një gjë, para të vjedhura, krim dhe drogë, dhe me këto mendoni të rri në pushtet! Të jesh i sigurt, Ulsi, se ngordhja po ju vjen politikisht!